



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KPA SHTYN SËRISH SEANCËN E SUBJEKTIT ZNJ. ALMA BRATI, DALIN

DENONCIME TË REJA!

Te premten, datë 12 prill u zhvillua në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit seanca gjyqësore e Znj. Alma Brati, Gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kryetarja e trupit gjykues në çelje të seancës ftoi subjektin e rivlerësimit për të paraqitur prapësimet dhe prova të tjera.

Znj. Alma Brati kërkoi ri llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë KPA-së sepse ekzistojnë disa pasaktësi matematikore. Përpos kësaj argumentoi si më poshtë :

-Analiza në vitet 1999-2002 në lidhje me të ardhurat e babait të subjektit, nuk janë marrë në vlerën e plotë të tyre.

-Analiza në vitet 2007,2008,2009 ku është llogaritur kostoja e jetesës, duhet të llogaritet për 3 persona sepse subjekti kishte statusin e ndarë nga ish-bashkëshorti, jo për 4 persona siç është llogaritur.

- Në analizë nuk janë njohur të ardhurat nga pensioni ushqimor që paguante ish-bashkëshorti i subjektit.

Znj Alma Brati argumentoi gjithashtu para trupit gjykues disa prova të reja: një dokument të marrë nga autoritetet italiane në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e Zotit L.K një tjetër person i lidhur me subjektin; prova indirekte për të provuar të ardhurat e babait te saj; subjekti këmbënguli se KPA duhet të merrte parasysh faktin se një pjesë e dokumenteve nuk mund të siguroheshin për shkak se institucionet ishin djegur në vitin 1997 dhe përdori nenin 49/3 të Ligjit nr. 84/2016 “...ose faktet e njohura botërisht nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme” dhe ky ishte i tillë; vërtetime bankare nga Banka Kombëtare Tregtare në lidhje me nënën e saj, dhe shkresa të tjera në cilësinë e provës.

Komisioneri Publik u shpreh se dhe për të ekzistojnë disa problematika në lidhje me analizën financiare, por theksin e vuri tek një denoncim i ardhur me datë 11 prill, një ditë para seancës. Komisioneri paraqiti një dokument sipas të cilit personi L.K. që është person i lidhur me subjektin, kishte marrë 2 kredi bankare në Itali në vitin 2000 dhe në vitin 2006. **KPA-ja këtë dokument e vendosi në dispozicion të Znj Alma Brati dhe menjëherë replikoi Komisioneri Publik mbi ruajtjen e anonimatit të denoncuesit.** Trupi gjykues qëndroi pasive pas kësaj replike, dhe njohu subjektin dhe me një denoncim tjetër të ardhur pranë ONM-së.

Pas kësaj trupi gjykues, kërkoi shtyrje seance dhe u rikthye në orën 13.00, ku shpalli 3 vendime të ndërmjetme dhe më konkretisht:

1.Të lejojë marrjen e provave që parashtroi subjekti i rivlerësimit, përveç kartelës shoqëruese për praktikën e ndjekur pranë Drejtorisë së Policisë (në lidhje me babain e subjektit) për të cilën trupi gjykues argumentoi se nuk merret në cilësinë e provës.

2. Të caktojë një përkthyes nga listat e përkthyesve të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me denoncimin e ardhur tek ONM-ja.

3. Shtyrjen e seancës me 26 prill ora 10.00 për t'i dhënë kohë subjektit të njihet me denoncimet.